



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 777/prot.

Tiranë, më 30.11 2022

V e n d i m

Nr. 69 datë 30.11 2022

Për krijimin e njësisë kërkimore-studimore të përkohshme

Instituti Kombëtar i Matematikës (IKM)

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 30.11 2022, me propozimin e Seksionit të Shkencave Natyrore Teknike nr. 777, dt. 24.11.2022 (bashkëngjitur), mbështetur në nenin 4 pika 6 dhe nenin 19 pikat 1 dhe 3 të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; si dhe neneve 44 dhe 46 të Statutit të saj,

Vendosi:

1. Krijimin e njësisë kërkimore-studimore të përkohshme në fushën e matematikës, me emërtimin *Instituti Kombëtar i matematikës (IKM, virtual)*;

2. Bordi drejtues i njësisë përbëhet nga këta anëtarë:

- Skënder Gjinushi, akademik, Kryetar i AS, - Kryetar
- Fioralba Cakoni, anëtare e jashtme e ASH, Drejtore Ekzekutive, Rutgers University, SHBA - Anëtare
- Fatmir Hoxha, profesor, UT, kryetar i KMI - Anëtar
- Akli Fundo, profesor, UPT anëtar i KMI - Anëtar
- Nertila Gjini, profesore, UNYT - Anëtare
- Sokol Kaliaj, prof.asoc, UE "Aleksandër Xhuvani" anëtar i KMI - Anëtar
- Stefan Janaqi, PhD, Ecole des Mines d'Alès, Francë - Anëtar
- Erida Gjini, PhD, Instituto Superior Técnico Lisbon, Portugali, anëtare e AR, anëtare e KMI - Anëtare
- Niko Kaçiroti, PhD, Universiteti i Michiganit, SHBA - Anëtar
- Eglantina Kalluçi, prof.asoc., FSHN, UT - Koordinatore

3. IKM do të funksionojë sipas platformës bashkëngjitur. Deri në fund të muajit qershor 2023, bordi drejtues i IKM të miratojë platformën përfundimtare të funksionimit dhe të miratojë statutin.

4. Brenda muajit qershor 2023, IKM të ketë përfunduar evidentimin e grupeve kërkimore-studimore brenda vendit, në vendet e tjera fqinje si dhe në botë, të cilat mund të ofrohen për bashkëpunim, duke thëlluar fazën e parë të anëtarësimit dhe duke realizuar forumin e parë të matematikes.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i SSHNT, Sekretari Shkencor dhe Kancelari.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

